

Jakov Xoxa

Hyrje në shkencën e letërsisë

Botim fototipik me rastin e 100-vjetorit të lindjes së autorit,
sipas botimit të Universitetit të Prishtinës (1970)

(Shoqëruar me studimin hyrës të akad. Rexhep Qosja *Drama e historisë sonë*, shkruar për botimin e plotë të veprës letrare të Jakov Xoxës, përgatitur nga akad. Ali Aliu dhe botuar nga *Rilindja*, Prishtinë 1991)

Tiranë 2023

Jakov Xoxa
Hyrje në shkencën e letërsisë
Botim fototipik me rastin e 100-vjetorit të lindjes

Përgatiti për botim: Anila Sofka

Redaktore: Anila Ajdini

Recensues: Shaban Sinani, Blerina Suta

Art design: MB

Botimet Enja

ISBN: 978-9928-806-02-4



Fondacioni Fan Noli

Botimi i këtij libri u mundësua nga
Fondacioni për Kulturë e Arte "Fan Noli",
në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.



UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

HYRJE NE SHKENCEN *e letërsisë*

Përshtatur nga : J. Xoxa

Shtypur në Drejtorinë e Botimeve të U.S.H.T.

Tiranë, 1969

Botimi I-rë 1962 Rip.1969

Tirazhi 1000

Fac-simile e ballinës së librit *Hyrje në shkencën e letërsisë*, që përmendet në këtë studim, bot. i USHT i ripunuar, Tiranë 1969 (bot. i parë USHT 1962).

Përmbajtja e lëndës

- *“Hyrje në shkencën e letërsisë”*: një histori e shkurtër gjenetike rreth ndihmesave të Jakov Xoxës për çështje të teorisë së letërsisë (**Shaban Sinani**)VII
- Manuali teoriko-letrar i Jakov Xoxës - një teori marksiste për artin në kufijtë e ortodoksisë (**Blerina Suta**)VIII
- **Hyrje në shkencën e letërsisë (Jakov Xoxa)**1
- *Drama e historisë sonë*, shenjim hyrës botimit të veprës së plotë letrare të Jakov Xoxës, *Rilindja*, Prishtinë 1971, nga akademik **Rexhep Qosja** 177

Manuali teoriko-letrar i Jakov Xoxës - një teori marksiste për artin në kufijtë e ortodoksisë

Botimi i manualit teoriko-letrar “Hyrje në shkencën e letërsisë” në Universitetin e Prishtinës në 1970 vjen si e “përshtatur” nga Jakov Xoxa, ribotim i variantit të Universitetit të Tiranës të 1967, *me pak ndryshime të natyrës specifike*. Ndonëse përgatitësi e paraqet si të ‘përshtatur’ këtë tekst hyrës në shkencën e letërsisë, ilustrimi i koncepteve teorike përmes autorëve të letërsisë shqipe, lejon të nënkuptosh se vepra bart një aks teorik dhe metodologjik, të cilin studiuesi (dhe shkrimtari Xoxa) e sheh në përputhje me konceptin e tij për artin dhe letërsinë.

Duke u ndalur vetëm në këtë variant të 1970 mund të pohojmë se konceptet që vijnë prej tij shënojnë një ngjarje të rëndësishme për specialistët e fushës së studimeve letrare, edhe pse periudha postkomuniste priret t’i anashkalojë fenomenet që i takojnë periudhës diktatoriale pa një analizë në perspektivë historike.

Konceptet më të rëndësishme që bart ky manual janë marrë nga tradita e marksizmit rus, të përfaqësuar nga idetë e Leninit dhe Plehanovit, si dhe nga ajo estetiko-materialiste e shekullit XIX të Gogolit dhe Bjelinskit.

Vija e hollë rreth të cilës mund të sendërtohet një trajtesë e tillë është dinamika e përafrimit të materialeve të përzgjedhura me analizën historiko-dialektike: pohimi për thelbin figurativ të artit, sipas të cilit *figurat në art kanë një karakter emocional* kryhet në përplotësim të konceptit të “realizmit”, koncept kyç i aksit teoriko-metodologjik të këtij manuali.

“Realizmi” kërkohet jo vetëm si funksion i krijimit artistik sipas frymës së kohës, por dhe i kritikës letrare që transformohet në ndërgjegje të realitetit dhe thuhet bart në mënyrë të gërshetuar apo madje zëvendëson dijat historiko-filozofike apo sociologjike.

Plazmimi i veçorive të artit sipas veçorive të jetës përgjatë gjithë prerjes metodologjike të tekstit, përcjell teorinë njohëse të Leninit për “rëndësinë shoqërore të letërsisë” dhe rrjedhimisht edhe karakterin konfliktual të kësaj teorie që rrjedh prej mitizimit të konceptit historik dhe sponsorizimit të një receptimi pasiv të tekstit letrar.

Por nga ana tjetër, ky manual ka vlerë për qëndrimi kritik sipas të cilit, vlera sociale e letërsisë (pra mendimi, historia që përçohet nga e vërteta artistike) hetohet nëpërmjet koncepteve që i brendashkruhen mjeteve diskursive të realizimit poetik të veprës.

Kështu, autori gjen hapësirën të flasë për natyrën gjuhësore të disa mjeteve specifike të sendërtimit të poetikës “realiste”, si *partishmëria*, *tipikja*, *karakteri popullor*, të cilat në metodën e realizimit socialist do të shihen tërësisht jashtë veprës.

Koncepti i i “partishmërisë” në letërsi që hasim në këtë manual ndërfitet në një rrafsh më të gjerë arsytimi mbi karakterin ideologjik të artit dhe është larg interpretimit që do bartë koncepti i realizimit socialist për letrarët si ndihmës të partisë në edukimin komunist të njerëzve.

Partia, në konceptin teoriko-metodologjik të zgjedhur prej Xoxës, hetohet në hapësirën që i takon klasës sociale dhe ideologjisë që ajo përfaqëson dhe, në mënyrë specifike, partishmëria, si *gjendje shpirtërore e një klase të caktuar*, trajtohet si tregues i kalimit të ndërgjegjshëm të shkrimtarit në anën e lëvizjes përparimtare shoqërore.

Ngushtësisht i lidhur me konceptin e realizimit është kategoria e “tipikes”, të cilën Jakov Xoxa e përkufizon sipas manualit të Engelsit

si “vërtetësi në dhënien e karaktereve tipike të marra në rrethana tipike”.

Duhet theksuar se, ndryshe prej lakimit të këtij koncepti, në teorinë e realizmit socialist, sipas të cilit “duhen vërejtur shumë njerëz të ngjashëm për të krijuar një tip të caktuar” (*Fjalor Termash letrare*, 1965), e vërteta dhe figura tipike në manualin e Xoxës përvijohet si shprehje e *kompozimit të figurave, thellësisë së gjuhës artistike*.

Edhe kur përmend tipiken, si cilësi pasqyruese e kushteve “shoqërore të shumë njerëzve”, autori kujdeset të theksojë natyrën e dyfishtë të së vërtetës artistike: nga njëra anë, shpreh jetën dhe, nga ana tjetër, qëndrimin ideo-emocional të shkrimtarit ndaj jetës.

Kështu, tipikja në këtë manual ndriçohet në optikën e mjeteve të fantazisë krijuese, pra të mundësive formale që e shohin mjetin specifik të letërsisë në *hollësitë e të kompozuarit të figurave, dhe hollësitë e gjuhës artistike të veprës*, që e pasqyrojnë karakterin *siç është, tipik, por dhe të bymuar apo tkurrur*.

Koncepti i tipikes si *diçka që mund të ndeshet dhe mund të ngjasë*, siç shprehet Xoxa duke iu referuar artikullit të Gorkit për “Onjeginin” dhe qartësimi i këtij koncepti për tipiken, si kërkim në faktet e jetësore të asaj ç’ka është *e ligjshme jo e rastit*, sugjeron një koncept të së “ligjshmes” në rrafshin cilësor dhe logjik të së mundshmes aristoteliane.

Në funksion të “realizmit” proces i gjallë i njohjes (dhe jo abstrakt) përdoren dhe argumente për “karakterin popullor” të artit.

Në përvijimin e karakterit popullor të letërsisë, Xoxa ka zgjedhur ato përcaktime që e përvijojnë si funksion të tiparit formal dhe gjuhësor, falë *figurave artistike, të kësaj kohe (të jetës së popullit, të udhëheqësve të tij, të gjuhës së tij, të vendeve, fushave, maleve të bukur shqiptarë, të zakoneve, të veçorive pozitive të masave popullore)*.

Kontradiktat e thella që vëren Lenini, në profilin letrar të Lev Tolstojit *si pasqyrë e revolucionit rus*, apo Balzaku që *ka demaskuar atë sistem shoqëror, partizan i të cilës qe*, shoqërohen gjithsesi nga arsytimi për vlerën njohëse që bart realizmi i këtyre autorëve, falë gjenialitetit, cilësi që *nuk mund të fshehë kurrë të vërtetën e jetës*.

Së fundi, dhe ndoshta koncepti më i rëndësishëm që qarkullon në këtë vepër është ai i “formës”. Analizat e traditës materialiste të shekullit XIX, specifiku të Gogolit dhe Bjelinskit, sjellin në këtë vepër një koncept të karakterit popullor të artit, si shprehje e “formës demokratike” e cila nuk është *vetëm gjuha, që të jetë e kuptueshme dhe jo e rëndë, por duhet shikuar si forma në tërë kompleksitetin e saj*.

Kompleksiteti, një cilësi e lidhur me teknikën e veprës letrare apo *mënyrën e aftë* të ndërtimit të saj, fiton tipare akoma më të qarta, kur krahas marrëdhënieve të veprës me botën jashtë saj (sipas konceptit të Leninit që i krahason marrëdhëniet mes komponentëve të veprës me lidhjet universale të jetës vetë - gjuha identifikohet me jetën vetë), propozohen si thelbësore marrëdhëniet brendashkruar veprës, si ai i rrafshit të personazhit (kur përmenden *marrëdhënie reciproke të një karakteri me karakteret e tjera*), apo ai i rrafshit të veprimit (kur *shkrimtari bashkon fenomenet në mes të tyre në të tillë mënyrë që këto gjatë veprimeve të tyre reciproke të plotësojnë njëra tjetrën, të formësojnë njëra tjetrën*).

Marrëdhëniet (*lidhje të ndryshme komplekse*) në vepër e orientojnë domethënien e saj drejt të vërtetës së kuptueshme dhe të përvetësueshme që vjen (ndryshe nga estetika e realizmit socialist) brendashkruar veprës si *tërësi stilistike, një ndërtesë e përcaktuar, rezultat i idesë themelore* e cila varet nga *përmbajtja e veprës*, e po kështu nga *arti i gjuhës*.

Ideja e veprës letrare si *një të tërë unike, të organizuar nga ideja themelore, të organizuar pra nga qëndrimi i vetëm i njëjtë që*

mban shkrimtari ndaj jetës shoqërore, rreth së cilës grumbullohen mjetet gjuhësore (mjetet konkretizuese të tablove të jetës; mjetet individualizuese të karaktereve; mjetet tipizuese të karaktereve), na çon madje në thelbin aristotelian të së vërtetës artistike si forcë që krijon tensionin e duhur për të siguruar stilin kompakt të saj.

Si përfundim, teoria dhe kritika e realizmit socialist në shërbim të luftës pa kompromis të klasave që do të instalohet dhe do të vazhdojë në dhjetëvjeçarët e ardhshëm, rezulton cilësisht e ndryshme prej sugjestionit transformues që Jakov Xoxa mundohet t'i veshë funksionit të letërsisë, edhe kur përvetëson për rrafshin e kritikës letrare konceptin romantik të qëndrimit ndaj jetës, *atë ëndërr të njeriut, që është e zonja të shtojë energjitë e njeriut në transformimin pozitiv të jetës, në transformimin revolucionar të jetës.*

Zgjedhja 'autoriale' e çështjeve bazë të shkencës së letërsisë (që nga veçoritë e artit dhe të letërsisë deri tek ato më specifike që kanë të bëjnë me çështje të gjuhës dhe organizimit figurativ të saj në veprën letrare, me elementet e vjershërimit, të gjinive letrare), kryhet në kuadër të funksionit të ndryshimit revolucionar që letërsia do duhet të përcillte në shoqëri. Konstantja e ndryshimit kërkohet në kufijtë e jashtëm të klimës teoriko-kritike që prodhoi ortodoksia staliniste me modelin e censurës së ashpër të praktikës zhdanoviane të letërsisë, e cila vinte përmasën sociologjike të artit në shërbim të nevojave të partisë.

Blerina Suta

Universitá L'Orientale di Napoli